



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 712/1 Prot.

Tiranë, më 12 . 06 . 2023

**V E N D I M**

**Nr. 99 , Datë 12 . 06 . 2023**

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është paraqitur ankesa nr. 175, datë 11.11.2022, e znj. R.Gj kundër znj. A.LI, Drejtore e Shkollës Profesionale Pyjore “Kolë Margjini”, Shkodër, në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “*bindjes politike*<sup>1</sup>” dhe “*çdo shkak tjetër*<sup>2</sup>”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

**K O N S T A T O I:**

**I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.**

Sipas shpjegimeve të dhëna, subjekti ankues në mes të tjerash informon se: “*Kam filluar punë si mësuese e lëndëve profesionale në shkollën pyjore në datë 23.03.2021. Me shkresën nr. 190, datë 18.10.2022, jam njoftuar për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës, për arsye të përsëritura si më poshtë: - Mos respektim i orarit në punë; - Mos respektim i kodit të etikës; - Mos plotësim të ditarit; - Dorëzim të “ditarit të mësuesit” vetëm me temat mësimore; - Paraqitje jo dinjitoze në pjesëmarrjen në një projekt të deleguar nga drejtoria e shkollës; - Mos respektim i orës së mësimit, duke tjetërsuar orën e mësimit, në orë pastrimi mbeturinash; - Mos respektim të orës së mësimit, duke nisur orën me vonesë deri në 10 minuta; - Larguar jashtë vendit pa njoftim paraprak në drejtori, duke cënuar procesin mësimor.*”

<sup>1</sup> Referuar Vërtetimit nr. 36, datë 10.12.2022 të lëshuar nga Partia Demokratike Dega Lezhë, vërtetohet se ankuesja në zgjedhjet e datës 25.04.2021, ka qenë anëtare në Qendrën e Votimit nr. 740, KZAZ nr. 12, Qarku Lezhë.

Referuar Vërtetimit nr. 1 dhe nr. 2, datë 15.11.2022, të lëshuar nga Kryetari i Forumit Rinor të Partisë Demokratike, vërtetohet se dy fëmijët e ankueses, janë anëtarë të FRPD.

<sup>2</sup> Ankuesja deklaroi se: “*Drejtueses së shkollës i intereson lirimi i vendit të punës dhe në vendin tim mund të vendoset një militant partie. Mendoj se drejtuesja ka diçka personale, të pashpjeguar*”.

*Drejtuesja e shkollës ka disa muaj që më bën presione në forma të ndryshme, duke improvizuar, shpifur dhe sajuar kundër meje, këtë fakt e tregon dhe takimi për bisedim në lidhje me ndërprerjen e marrëdhënieve të punës, ku ajo nuk paraqiti asnjë argument apo provë të ligjshme, se unë kam bërë shkelje gjatë ushtrimit të detyrës si mësuese. Nuk kam qenë dakord as me mbajtjen e procesverbalit, pasi nuk ka pasqyruar të gjitha sa është biseduar. Kam të gjitha provat se:*

- *Kam zbatuar me përpikëri orarin e punës, pasi deri më sot nuk kam asnjë vërejtje me shkrim për orarin, ku të mos kem njoftuar drejtuesen.*
- *Kam respektuar me përpikëri dhe sipas ligjit, Kodin e Etikës, pasi nuk kam asnjë vërejtje me shkrim nga Komisioni i Etikës dhe Komisioni i Disiplinës.*

*Të gjitha veprimet e drejtueses së shkollës vijnë si shkak i bindjes politike, pasi vij nga një familje e cila njihet për aktivistë të Partisë Demokratike në qytetin e Lezhës. Kunati im ka qenë për rreth 5 mandate Kryetar i Komunës Ungrej në Qarkun e Lezhës nën siglën e PD, unë kam marrë pjesë vazhdimisht në protesta, si dhe fëmijët janë anëtarë të FRPD Lezhë. Ndërsa drejtuesja e shkollës është vendosur në pozicionin që mban si militante partie, pasi nuk plotëson kriteret për të qenë drejtuese shkollë”.*

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit dhe kthimin në vendin e punës.

## **II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.**

Hapat proceduralë të ndjekur nga strukturat përkatëse të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, paraqiten si më poshtë vijojnë:

Pas analizimit paraprak të ankesës, u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33/3 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar. Në këto kushte Komisioneri, filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.

- Me shkresën nr. 1477/1, datë 17.11.2022, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka njoftuar dhe kërkuar informacion nga subjektet, për ankesën e bërë nga znj. R.Gj si dhe ka kërkuar aktet e poshtë cituara:
  - Kopje të plotë të procedurës së ndjekur për përfundimin e marrëdhënies së punës me znj. R.Gj.
  - Kopje të të gjithë masave disiplinore të dhëna ndaj ankuses, kundërshtimeve të saj dhe përgjigjeve të dhëna nga institucioni.
  - Kopje të procedurës së marrjes në punë të ankuses dhe kopje të Kontratës së Punës.
  - Kopje të vlerësimit të punës së ankuses për vitet: 2021 dhe 2022.
  - Kopje të Urdhrit të ngritjes së Komisionit të Etikës dhe Komisionit të Disiplinës së shkollës, për vitin 2021 dhe 2022 dhe kopje të procesverbaleve të mbajtura nga këto komisione, lidhur me trajtimin e çështjeve të znj. R.Gj.
  - Kopje të Rregullores së Brendshme dhe Kodit të Etikës të institucionit.

- Kopje të procedurës së emërimit të Drejtores së shkollës, znj. A.Ll.
- Informacion për mësues të tjerë që i janë ndërprerë marrëdhëniet e punës, nga data 01.09.2021 deri në datë 01.09.2022.
- Informacion për mësues të tjerë për të cilët janë marrë masa disiplinore për: mosrespektim të orarit mësimor, mosrespektim i kodit të etikës, mosplotësim të ditarit, dorëzim të “ditarit të mësuesit” vetëm me temat mësimore, paraqitje jo dinjitoze në pjesëmarrje në projekt, mosrespektim i orës së mësimi, mosrespektim i fillimit të orës së mësimi dhe largim jashtë vendit pa njoftim paraprak në drejtori, nga data 01.09.2021 deri në datë 01.09.2022.
- Informacion nëse kjo çështje po ndiqet në gjykatë. Nëse po, një kopje të akteve.

Me shkresën nr. 215, datë 25.11.2022, Shkolla e Mesme “Kolë Margjini”, Shkodër, në mes të tjerash informoi Komisionerin se: *“Znj. R.Gj është punësuar në shkollën pyjore “Kolë Margjini” Shkodër, me datë 23.03.2021, si mësuese e lëndëve profesionale në përputhje me procedurat e parashikuara në nenet nr. 29, 30 dhe 31 të Udhëzimit nr. 11, datë 03.03.2020 “Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarinë e ofruesve publikë të arsimit dhe formimit profesional”.*

*Emërimi si drejtuese shkolle me nr. 37774/2, datë 05.01.2021, është bërë në përfundim të procedurave të konkurimit të kryera, bazuar në shpalljen datë 03.11.2020, për drejtues, në përfundim të cilave jam shpallur fituese.*

*Gjatë vitit shkollor 2021-2022, janë konstatuar shkelje të vazhdueshme të znj. R.Gj, të mos paraqitjes në punë brenda orarit, duke mos bërë asnjë njoftim paraprak tek drejtori i shkollës. Në ankesën e saj znj. R.Gj pretendon që nuk ka marrë asnjë njoftim apo vërejtje nga drejtuesi i shkollës në lidhje me paraqitjen e saj në punë, kjo nuk rezulton e vërtetë, pasi unë si drejtuese jo vetëm ia kam komunikuar shkeljet e saj, por e kam thirrur në drejtori ku e kam këshilluar që të respektojë orarin si të gjithë mësuesit e tjerë. Pavarësisht kësaj, znj. R.Gj ka vazhduar sërish me mosrespektimin e orarit mësimor, ndaj unë si drejtorë e shkollës e kam ftuar sërish në drejtori duke e mbajtur me protokoll takimin, ku i është tërhequr vëmendja që të respektojë, rregulloren e shkollës si dhe Udhëzimin nr. 14, datë 27.05.2021. Në vijim, znj. R.Gj ka udhëtuar për në Itali dhe me datë 11.04.2022, nuk ka qenë e pranishme në shkollë për të zhvilluar mësimin dhe ka njoftuar në drejtori vetëm 9 minuta para fillimit të procesit mësimor. Për këtë shkak i është hequr dita e punës dhe është njoftuar me shkresën nr. 79, datë 12.04.2022, ku i është kërkuar përsëri të respektojë rregulloren e shkollës, në të kundërt do të merren masa disiplinore sipas legjislacionit në fuqi. Znj. R.Gj është përgjigjur me shkresën nr. 23, datë 22.04.2022, ku pretendon se telefonatën e ka bërë me datë 11.04.2022, në orën 7.45, për të më njoftuar mbi mos paraqitjen në punë. Si drejtuese i jam përgjigjur pretendimit të saj me shkresën nr. 88, datë 22.04.2022 ku i kam bashkëngjitur edhe komunikimin që kemi bërë me mesazhe, ku duket qartë ora e njoftimit.*

*Znj. R.Gj s’ka pasur probleme vetëm me respektimin e orarit mësimor por edhe me performancën e saj si mësuese. Gjatë vitit të parë të punës, mësuesja nuk ka dorëzuar Ditar të Mësuesit, por edhe kur e ka dorëzuar nuk ka qenë në formën e duhur por vetëm disa tema*

mësimore, ndërkohë që tek ditari duhet të shtjellohet e gjitha ajo çfarë ndodh në një orë mësimore, siç e kanë dorëzuar të gjithë mësuesit. Për këtë fakt, unë si drejtor e institucionit i kam tërhequr vëmendjen në vazhdimësi. Në vitin e parë, znj. R.Gj ka marrë edhe trajnime si mësuese e re, nga Përgjegjësja e Njesisë së Zhvillimit, në lidhje me Plan Ditarin e Mësuesit, si edhe për Planet Mësimore vjetore, siç edhe është deklaruar vetë nga kjo e fundit në email-in e drejtuar në Drejtorinë e Përgjithshëm të AKPA-s.

Në takimet e zhvilluara në drejtorinë e shkollës, në prani të Përgjegjëses së Burimeve Njerëzore dhe të Sekretares së shkollës, znj. R.Gj nuk ka dhënë asnjëherë asnjë argument në lidhje me vërejtjet e marra dhe nuk ka paraqitur asnjë ankesë në lidhje me këto vërejtje, vetëm pas takimit në AKPA, ku ju kërkua se pse nuk keni bërë asnjë ankesë apo kundërshtim për vërejtjet e marra, me datë 28.10.2022 ka depozituar në sekretarinë e shkollës ankesën nr. 31, për të cilën ka marrë edhe përgjigje, me shkresën nr. 197, datë 01.11.2022.

Bashkëlidhur do gjeni kopje të urdhrimit të ngritjes së Komisionit të Etikës dhe Disiplinës, ndërsa procesverbale nga këto komisione nuk kemi.

Znj. R.Gj është kërkuar nga ana ime të kalojë në Komisionin e Etikës për veshjen dhe është zhvilluar edhe mbledhja nga ky komision, e dokumentuar me procesverbalin e mbajtur me datë 15.09.2022, ku u dha masa vërejtje për ankuesen. Në procesverbal është shënuar edhe fakti që zonja kërcënoi një anëtarë të komisionit, duke i thënë që do t'ju ngel djalin në klasë, pasi znj. R.Sh nuk ishte vetëm anëtarë e komisionit por dhe prindi i nxënësit R.Sh.

Procesverbali i Komisionit të Etikës nuk u zbardh, pasi u pretendua që komisioni me 4 anëtarë ishte jo me kuorumin e duhur, pasi duhet të kishte në përbërje 5 ose 7 anëtarë. Komisionet janë ngritur përpara emërimit tim si drejtuese e shkollës dhe janë lënë me dakordësi të të gjithë këshillit pedagogjik me 4 anëtarë, për arsye se kemi numër të ulët mësuesish por edhe nxënësish, pasi nuk janë vetëm këto dy komisione, por janë edhe Komisioni i Shëndetit, Komisioni i Vetëvlerësimit, Komisioni i Sigurisë dhe numri prej 11 mësuesish nuk mjaftonte. Një kopje e protokollit të mbajtur gjatë takimit të këtij komisioni ku kanë firmosur 4 anëtarët e tij do tu vihet në dispozicion. Unë si drejtuese e gjendur përballë këtyre fakteve dhe duke qenë se ishin akoma në fuqi komisionet e vitit 2021-2022, për vitin shkollor 2022-2023 organizova të gjithë procedurën për ngritjen e Komisionit të Etikës dhe Komisionit të Disiplinës, me anëtarë të rinj dhe me nga 5 anëtarë. Znj. R.Gj më pas nuk u kalua në komisionin e ri të etikës pasi gjatë një kontrolli për Plan Ditarin e Mësuesit u gjet me një ditari ku ishin të shkruara vetëm temat mësimore, ku ju dha edhe një vërejtje dhe u vendos të thirret për të biseduar mbi vazhdimësinë e marrëdhënieve të punës.

Nga data 01.09.2021 deri në datë 01.09.2022, nuk i është ndërprerë marrëdhënia e punës asnjë mësuesi.

Lidhur me masat e marra për mësues të tjerë, informojmë se mësueses D.B i është hequr një ditë pune për paraqitje me vonesë në punë, pa njoftuar në drejtori. Meqenëse ishte hera e parë që paraqitej me vonesë, është mjaftuar vetëm me qortim dhe hequr dita e punës.

*Ndërsa përsa i përket daljes jashtë vendit të mësuesve të tjerë, rezulton vetëm një rast, ku jam njoftuar një javë para nga tre mësuese që donin të largoheshin jashtë vendit, të cilët kanë kërkuar leje pa të drejtë page dhe u janë hequr tre ditë pune.*

*Përsa i përket plotësimit të Plan Ditarit nga mësues të tjerë, nuk rezulton asnjë rast ku mësues të tjerë të mos kenë dorëzuar ditarin, kur është kërkuar nga drejtuesja e shkollës”.*

*Në kundërshtim të shkresës së Shkollës së Mesme “Kolë Margjini”, Shkodër, subjekti ankues me email-in datë 05.12.2022, në mes të tjerash ka parashtruar se: “Referuar pretendimit për paraqitje me vonesë në punë ju bëj me dije se në shkollë ka një listë-prezencë të cilën e firmosim çdo ditë në momentin që hyjmë në institucion, emri im është ndër pesë-gjashtë mësuesit e parë që hyjnë në shkollë. Listë-prezenca e muajit qershor 2022, përkatësisht data 16 dhe 17 (bashkëlidhur lista), ditë për të cilat më është hequr dita e punës me pretendimin se kam ardhur me vonesë dhe që jam njoftuar për këtë gjë, ditë më pas dhe pse unë kisha qëndruar në punë deri në orën 13.30.*

*Referuar udhëtimit për në Itali pa njoftuar më parë në drejtori, ju bëj me dije se, kam udhëtuar në ditë pushimi për arsye shëndetësore të paplanifikuara, pasi vuaj nga një sëmundje kronike, gjë për të cilën është në dijeni drejtoresha, jam larguar në ditë pushimi dhe kthimi ishte planifikuar të bëhej po në ditë pushimi. Meqë pati një vonesë në nisje të avionit, kam telefonuar drejtoreshën për ta lajmëruar dhe rrjedhimisht për të hequr dhe ditën e punës. Në linjë telefonike nuk jemi kuptuar dhe atëherë në orën 07.47 i kam shkruar mesazh, ku i kam sqaruar arsyen e mos paraqitjes në punë. Duke shpresuar në mirëkuptimin e saj, por që nuk rezultoi ashtu, pasi dhjetë ditë më vonë, në datë 21.04.2022, më bën vërejtje me shkrim për mosparaqitje në punë.*

*Në muajin qershor më janë hequr dy ditë pune, me pretendimin se kam ardhur me vonesë, gjë e cila nuk është e vërtetë dhe këtë e vërteton listë prezenca.*

*Në datë 12.09.2022, filloi viti i ri shkollor dhe me datë 15, nëpërmjet sekretares njoftohem që po atë ditë në orën 12.00 duhet të paraqitem përpara komisionit të etikës, pasi sipas drejtoreshës në mëngjes kur kam hyrë në shkollë, kam pasur veshje të papërshtatshme. Jam paraqitur në drejtori së bashku me komisionin dhe pas shumë diskutimesh dhe këmbëngulje nga drejtoresha, që të merrej vërejtje, komisioni ka refuzuar njëzëri për marrje mase, pasi paraqitja ime ishte në përputhje me etikën. Drejtoresha në shkresën nr. 215, ka përmendur që unë kam thyer Rregulloren e Shkollës dhe Rregulloren e Etikës. Unë që nga momenti që kam filluar punë në këtë institucion nuk më ka vënë njeri në dispozicion, as prezantuar asnjë lloj rregulloreje për të cilat akuzohem ti kem thyer.*

*Me datë 19.09.2022, drejtuesja na kërkon ditarët për ti kontrolluar dhe unë paraqes në drejtori dy ditarë, një për lëndët mësimore dhe një për modulet. Të dyja i kisha në formatin e vitit shkollor paraardhës dhe që i kisha të konfirmuara (firmosur) nga drejtoresha. Atë ditë me një komunikim aspak etik më bën vërejtje verbale duke më cilësuar si të paaftë dhe më pas më lajmëron sërish që do marrë vërejtje, për mosplotësim ditarit. Gjatë vitit shkollor 2022-2023, unë nuk kam marrë udhëzime të reja, as trajnime në lidhje me ditarin apo planet mësimore, por në mënyrë verbale nga*

*drejtoresha na është thënë të gjithë personelit mësimdhënës që vazhdoni siç i keni pasur vitin paraardhës.*

*Me datë 20.09.2022 njoftohem që duhet të paraqitem përpara komisionit të disiplinës pasi një anëtare e komisionit të etikës, njëherësh dhe prind i një nxënësi të shkollës tonë, kishte bërë një ankesë kundrejt meje që sipas saj e kisha kërcënuar se do i ngelja djalin në klasë. Që në formulimin e ankesës e kuptova që ishte një ankesë e mirë organizuar me qëllim për të më dëmtuar, pasi zonja në ankesën e saj kërkonte “Kërkoj nga komisioni i disiplinës të merret masë e rëndë ndaj mësueses”, normalisht ankuesja mund ti drejtohej drejtoreshës dhe më pas ishte kompetencë e saj, se çfarë rruge do ndiqej për ankesën. E vërteta është se këtë vit shkollor unë nuk i jap fare mësim djalit të saj (R. Sh), por ky detaj ju kishte shpëtuar, ndërsa në dy vite që i kam dhënë mësim, djali i saj është vlerësuar nga unë, me notat 8 dhe 9. Këtë e vërteton regjistri i vitit shkollor 2021-2022. Edhe në këtë rast, komisioni i disiplinës nuk mori masë ndaj meje. Sa për pretendimin që kemi shumë komisione, pak nxënës e pak mësues, prandaj nuk mund të ngrihen komisionet me katër anëtarë, ky është një pretendim i gabuar pasi sipas Udhëzimit nr. 14, datë 27.05.2021, neni 53, pika 5 përcakton se: “Në ofruesit e AFP-së me më pak se 24 klasa, komisioni përbëhet nga 5 anëtarë, kurse në ato me të paktën 24 klasa, bëhet me shtatë anëtarë” dhe shkolla jonë ka tetë klasa.*

*Këtë vit shkollor, nuk më është dhënë klasë në kujdestari dhe nuk jam caktuar në dezhurnin e shkollës. Në çdo rast që është pretenduar se është marrë vërejtje apo mbajtur proces-verbal për mua, të pranishme kanë qenë në të gjitha rastet, përgjegjësja e financës V.N dhe sekretarja S.M.*

*Me datë 19.10.2022 më ka ardhur në orën e mësimit, sekretarja me dy shkresa dhe bllokun e protokollit, ku më ka kërkuar të firmos një shkresë që mbante datën 25.05.2022 dhe një tjetër të datës 28.06.2022, pas refuzimit tim drejtoresha më ka thirrur në drejtori ku më ka bërë presion për ti firmosur, sigurisht për të më dëmtuar mua dhe unë me të drejtë kam refuzuar.*

*Duke parë vështirësinë për të komunikuar me drejtoreshën, me datë 15.09.2022, 21.09.2022 dhe 13.10.2022, i drejtohem me email drejtorit të përgjithshëm të AKPA-së, por nuk marr përgjigje. Përsëri i drejtohem AKPA-së me shkresë zyrtare dhe këtë herë më lajmërojnë që me datë 26.10.2022, duhej të paraqitesha për një ballafaqim me drejtoreshën, tek zyrat e AKPA-së. Paraqitemi përballë një komisioni të përbërë nga katër persona dhe unë dhashë argumentet e mia dhe vërejtjet që kisha ndaj drejtoreshës. Drejtores i lanë detyrë tu verë në dispozicion disa dokumente sipas ankesës time dhe më pas ata do i shqyrtonin. Nga ai moment nuk kam marrë asnjë përgjigje, as informacion.*

*Gjatë muajit tetor-nëntor 2022, kam shkëmbyer disa herë shkresa me drejtuesen e shkollës dhe kam vënë re se në protokoll janë shtuar shkresa dhe proces-verbale për mua, për të cilat nuk kisha dijeni dhe që të gjitha shkruanin “Refuzon firmën””.*

*Me shkresën nr. 4275/5, datë 09.12.2022, AKPA, në mes të tjerash informoi Komisionerin se: “Pranë AKPA janë dërguar dy ankesa, konkretisht:*

- Shkresa nr. 4275, datë 17.10.2022, me objekt “Ankesë ndaj drejtoreshës së Shkollës së Mesme Pyjore “Kolë Margjini”, Shkodër nga znj. R.Gj.
- Shkresa nr. 4275/2, datë 24.10.2022 me objekt “Ankesë në lidhje me vendimin e drejtoreshës së Shkollës së Mesme Pyjore “Kolë Margjini”, Shkodër.

Referuar ankesave të sipërcituara në zbatim të Udhëzimit të MFE-së, nr. 14, datë 27 .05.2021 “Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë së institucioneve të arsimit dhe formimit profesional, si dhe aspektet e menaxhimit të burimeve njerëzore, përbërjes së njësisë së zhvillimit të ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit”, me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të AKPA-s me nr. 4275/l, datë 20.10.2022, u ngrit Komisioni i Disiplinës, i cili mori në shqyrtim dosjen e plotë të dokumentacionit ligjor për të kryer verifikimet përkatëse në lidhje me ankesën e sipërcituar.

Komisioni i Disiplinës me Vendimin nr. 4275/4, datë 18.11.2022 ka vendosur:

- Të mos marrë në konsideratë ankesën e znj. R.Gj kundër drejtuesit të Shkollës së Mesme Pyjore, pasi veprimet e kryera nga drejtuesi i shkollës u gjetën në përputhje me legjislacionin në fuqi, në fushën e AFP-së.
- Të njoftohen palët e interesuara për këtë vendimmarrje, znj. R.Gj dhe znj. A.Ll, Drejtor i Shkollës së Mesme Pyjore “Kolë Margjini”, Shkodër”.
- Mbështetur në nenin 33/8, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, për shqyrtimin e mëtejshëm të ankesës, Komisioneri me shkresën nr. 196, datë 01.02.2023 njoftoi, palët për zhvillimin e seancës dëgjimore me datë 10.02.2023, për të parashtruar dhe argumentuar në mënyrë të drejtpërdrejtë pretendimet e palëve në proces, si dhe kërkoi kopje të dokumentacionit, si më poshtë:
  - Kopje të vlerësimit të punës së ankueses për vitet: 2021 dhe 2022.
  - Kopje të vendimit të largimit nga puna të znj. R.Gj.
  - Kopje të procedurës së marrjes në punë të punonjësit që ka zëvendësuar ankuesen.
  - Kopje të Rregullores së Brendshme të shkollës, që ka qenë në fuqi gjatë vitit shkollor 2021-2022.
  - Informacion mbi mospagimin e ditëve të punës, për mësuesen Znj. R.Gj dhe mësues të tjerë, gjatë vitit kalendarik 2022.

Bazuar në nenin 80/1/b të Kodit të Procedurave Administrative dhe Rregullores së Brendshme të Komisionerit, seanca dëgjimore u regjistrua audio dhe përmbajtja e saj do të përdoret si provë gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës.

Seanca u zhvillua në datë 10.02.2023, me praninë e të dy palëve në proces: subjekti ankues, znj. R.Gj, znj. A.Ll, Drejtore e Shkollës Profesionale Pyjore “Kolë Margjini”, Shkodër, dhe përfaqësuesve me autorizim nr. 4275/7, datë 07.02.2023, të AKPA-së, znj. E.M dhe znj. J.C.

Gjatë seancës dëgjimore, palët iu qëndruan të njëjtave parashtrime që kishin bërë të njohura gjatë komunikimit shkresor me KMD-në.

Gjatë seancës dëgjimore ankuesja në mes të tjerash deklaroi<sup>3</sup> se: “Kam filluar punë me dosje konkurimi në muajin mars 2021. Në datë 11.04.2022 kam munguar në punë pasi isha në Itali për një problem shëndetësor. Në datë 17.06.2022, drejtorja më shkruan mesazh, duke më thënë se përse nuk ke qenë në punë në datë 16.06.2022, sepse në kamera nuk shikohet që ke qenë në punë. I kam kthyer përgjigje, duke i thënë se kam qenë në punë, shiko listë prezencën, pyet dhe kolegët. Në fillim të vitit shkollor 2022, drejtorja nuk më ka caktuar klasë në kujdestari dhe dezurn, për arsye se kam qenë me shkelje (që kam munguar në datë 11.04.2022). Me datë 15.09.2022, sekretarja e shkollës më njoftoi se duhet të paraqitem para komisionit të etikës, se nuk kisha ardhur me veshje të përshtatshme. U paraqita dhe komisioni i etikës nuk mori vendim për shkelje të etikës. Në datë 20.09.2022, sekretarja e shkollës më njoftoi se duhet të paraqitem para komisionit të disiplinës, sepse një prind (anëtar i komisionit të etikës) është ankuar, se e kam kërcënuar se do i ngel djalën në klasë. Komisioni i disiplinës i tha drejtores se ne si komision shqyrtojmë ankesat e ardhura nga komisioni i etikës dhe nuk e gjejmë me vend që të diskutojmë për diçka që nuk kemi prova. Gjatë vitit shkollor 2022-2023, drejtorja ka vënë shënim vetëm njëherë në ditarin e moduleve që ky nuk është ditari që duhet, ndërkohë që ky ditar ka qenë i njëjtë me vitin e kaluar dhe ka qenë i firmosur nga drejtorja. Në datë 17.10.2022, drejtorja në zyrë më ka njoftuar për arsyet e zgjidhjes së marrëdhënieve të punës dhe me datë 18.10.2022, më ka dhënë lajmërimin për largimin nga puna. Me drejtoren e shkollës jam njohur përpara se të filloja punë, kur punoja në Bashkinë Lezhë dhe znj. A.Ll punonte për një shoqatë”.

Gjatë seancës dëgjimore znj. A.Ll në mes të tjerash deklaroi<sup>4</sup> se: “Ankuesen e njoh prej vitesh, përmes një projekti që kam pasur në vitet 2017-2019, në Bashkinë Lezhë. Ankueses i kam bërë thirrje që të punësohej si mësuese e lëndëve profesionale, nëpërmjet konkurrimit me dosje. Gjithashtu, njoh dhe bashkëshortin e saj dhe me kunatin e ankueses kam punuar në projekte të ndryshme dhe i di bindjet e tyre politike, por që për mua nuk ka pasur asnjë ndikim, si kur është marrë në punë e në vijim. Tre muaj pasi kishte filluar punë ankuesja kam kërkuar ditarin për të gjithë mësuesit dhe ishin 2-3 mësues që nuk e paraqitën ditarin, dhe për këtë i kam tërhequr vëmendje para Këshillit Pedagogjik. Ankuesen e kam thirrur disa herë në drejtori, për veshjen dhe ditarin. Komisioni i etikës dhe komisioni i disiplinës nuk pranuan që të zbardhnin procesverbalin e takimit, pasi thanë se komisionet përbëheshin nga katër anëtarë. Në datë 21.04.2022, ankuesja është njoftuar për heqjen e ditës së punës dhe jo për vërejtje. Në vijimësi ankueses i kam kërkuar ditarin dhe nuk e ka dorëzuar dhe e ka të pa firmosur nga ana ime. Sipas rregullit mësuesit duhet të paraqiten në shkollë në orën 07.45 minuta. Në datë 16-17.06.2022 ankuesja ka ardhur në shkollë në orën 08.34 minuta, pra me vonesë dhe për këto dy ditë i është dhënë vërejtje. Në librin e listë prezencës për datat 16-17.06.2022, ankuesja figuron se ka firmosur në orën 07.50, por firmat janë të falsifikuara dhe kjo listë prezencë nuk është dokument zyrtar dhe prandaj është ftuar ankuesja që të verifikojë kamerat. Edhe mësuesja D.B ka qenë me vonesë, por është paraqitur në

<sup>3</sup> Referuar seancës dëgjimore, minuta 05.30, e në vijim.

<sup>4</sup> Referuar seancës dëgjimore, minuta 41.30, e në vijim.



*drejtori ka parë kamerat dhe nuk ka bërë ankesë. Ankueses nuk i është caktuar dezhurn, pasi ajo vjen nga Lezha dhe kishte problematika të frekuentimit dhe linte nxënësit në korridor. Ankueses nuk i është dhënë klasë në kujdestari, pasi ishte mësuese që nuk plotësonte ditarin, ndërkohë që mësuesja kujdestare duhet të plotësojë regjistrin e një klase dhe duhet të bëjë të gjitha përmbledhjet në fund të regjistrit. Lidhur me vlerësimin e punës së mësuesit, nuk ka diçka të parashikuar se kur bëhet, por bëhet me kërkesë të mësuesit.*

Gjatë seancës dëgjimore përfaqësuesja e AKPA në mes të tjerash deklaroi<sup>5</sup> se: *“Jemi vënë në dijeni me shkresë nga ankuesja mbi problematikën e ngritur në shkollën pyjore. Është ngritur një komision që ka shqyrtuar çështjen në bazë të shkresave të vëna në dispozicion nga palët. Nga vlerësimi i dokumentacionit, rezulton se gjërat bëhen por nuk dokumentohen si duhet, pasi nuk i jepet rëndësia që kanë. Është shqyrtuar procedura për zgjidhjen e marrëdhënieve të punës dhe rezulton se është bërë njoftim për takim dhe është realizuar takimin mes palëve, pas 72 orëve. Shkollat profesionale nuk kanë të parashikuar një procedurë konkrete dhe të standardizuar të vlerësimit të punës për mësuesit”.*

Pas zhvillimit të seancës dëgjimore, ankuesja me email-et datë: 11.02.2023, 14.02.2023 dhe 23.02.2023, ka dërguar informacion dhe prova shtesë lidhur me pretendimet e saj.

Gjithashtu dhe Drejtorja e Shkollës Profesionale Pyjore “Kolë Margjini”, Shkodër me email-et datë: 13.02.2023 dhe 20.03.2023, ka dërguar informacion dhe prova shtesë lidhur me deklaratimet e bëra gjatë seancës dëgjimore.

### **III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.**

Ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 1 sipërcituar dhe nenin 3/1, parashikojnë se: *“‘Diskriminim’ është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.*

Gjatë shqyrtimit të ankesës dhe ndjekjes së procedurës hetimore, Komisioneri në përputhje me ligjin ka kërkuar informacionin e nevojshëm dhe dokumentacionin mbështetës, lidhur me rastin e subjektit ankues, në mënyrë që të mund të vlerësonte me objektivitet pretendimin e saj për trajtim të pa drejtë dhe diskriminues.

Komisioneri ka përmbushur kërkesat e parashikuara në Kodin e Procedurës Administrative, edhe sa i takon dhënies së ndihmës efektive, gjë e cila është përcaktuar në nenin 10, të tij: *“Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë*

---

<sup>5</sup> Referuar seancës dëgjimore, minuta 01.21.38, e në vijim.

*të jetë e mundur. Ai i informon palët mbi të drejtat dhe detyrimet e tyre, përfshirë të gjithë informacionin e lidhur me procedurën dhe i paralajmëron ato për pasojat ligjore të veprimeve ose mosveprimeve të tyre”.*

Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi, i ndryshuar, në nenin 32, pikën 2, të tij ka përcaktuar qartë këtë detyrim, duke cituar se: *“Të gjitha institucionet publike dhe subjektet private janë të detyruara të mbështesin Komisionerin, duke i dhënë informacionin që i nevojitet dhe duke i garantuar aksesin në informacionin në përmbushjen e detyrave të tij”.*

Në Kreun II, të këtij ligji, parashikohet mbrojtje e posaçme nga diskriminimi në fushën e punësimit. Ligji 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar, në nenin 12/1/c, ku përcaktohet se: *“Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me: ... c) trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimin, përfitimet dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës.”*, ndalon çdo lloj dallimi, kufizimi ose përjashtimi, bazuar në bindjet politike, që i bëhet një punëmarrësi në gëzimin e të drejtës për punësim.

#### **A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshëm.**

Gjatë shqyrtimit të ankesës rezultoi se me shkresën nr. 23584/1, 30.12.2020, të lëshuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE), znj. A.LI është ngarkuar përkohësisht në pozicionin e Drejtorit në Shkollën e Mesme Profesionale “Kolë Margjini” Shkodër dhe me shkresën nr. 23584/2, datë 29.01.2021, MFE ka miratuar propozimin për emërimin e znj. A.LI në pozicionin e drejtorit të institucionit.

Gjatë shqyrtimit të ankesës rezultoi se me shkresën nr. 27, datë 16.02.2021, të lëshuar nga Shkolla e Mesme Profesionale “Kolë Margjini” Shkodër (Shkolla), ankuesja në përfundim të konkurimit, është shpallur fituese për pozicionin *“Mësimdhënës i teorisë profesionale në drejtimin Përpunim Druri”* dhe me datë 23.03.2021, mes palëve është lidhur kontrata individuale e punës.

Me shkresën nr. 190, datë 18.10.2022, Drejtorja e shkollës ka njoftuar ankuesen për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës në përfundim të afatit dy mujor të njoftimit, me datë 23.12.2022, për arsye: *“Mos respektim i orarit në punë; Mos respektim i kodit të etikës; Mos plotësim të ditarit; Dorëzim të “ditarit të mësuesit” vetëm me temat mësimore; Paraqitje jo dinjitoze në pjesëmarrjen në një projekt të deleguar nga drejtorja e shkollës; Mos respektim i orës së mësimin, duke tjetërsuar orën e mësimin, në orë pastrimi mbeturinash; Mos respektim të orës së mësimin, duke nisur orën me vonesë deri në 10 minuta; Larguar jashtë vendit pa njoftim paraprak në drejtori, duke cënuar procesin mësimor”.*

Ankuesja kundërshton arsyen e largimit nga puna dhe pretendon se ndërprerja e marrëdhënieve të punës ka ndodhur për shkak të bindjes së saj politike, duke shpjeguar se, që nga fillimi i

marrëdhënieve të punës ka zbatuar orarin e punës, pasi nuk ka asnjë vërejtje me shkrim për orarin, ku të mos ketë njoftuar drejtuesen dhe ka respektuar me përpikëri dhe sipas ligjit, Kodin e Etikës, pasi nuk ka asnjë vërejtje me shkrim nga Komisioni i Etikës dhe Komisioni i Disiplinës.

Në këtë kontekst, sqarimi i fakteve dhe rrethanave në të cilat është marrë vendimi i punëdhënësit për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës me ankuesen, i shërben qëllimit për të gjykuar mbi vërtetësinë e motivacionit të largimit nga puna të deklaruar nga punëdhënësi, si dhe ligjshmërinë e këtij veprimi.

Nga aktet e administruara gjatë procedurës së shqyrtimit të ankesës rezultoi se në datë 11.04.2022 (ditë e hënë), znj. R.Gj në orën 07.48 minuta me anë të mesazheve telefonike ka komunikuar me drejtoreshën e shkollës, duke e njoftuar se nuk mund të paraqitet në punë, pasi ishte në aeroport në Itali dhe avioni ishte me vonesë. Drejtorja i ka kthyer përgjigje duke e informuar se duhej të kishte marrë leje dhe duhet ta kishte njoftuar në kohë për mungesën. Drejtorja e shkollës me shkresën nr. 79, datë 12.04.2022 ka njoftuar ankuesen se për arsye të mosparaqitjes në punë dhe njoftimit jashtë afateve të parashikuara në rregullore, do ti hiqet dita e punës. Referuar librit të protokollit të institucionit, rezulton se ankuesja ka firmosur se ka marrë dijeni për shkresën në datë 21.04.2022.

Me shkresën nr. 111, datë 26.05.2022, Drejtorja e shkollës ka marrë vendimin për dhënien e masës disiplinore “Vërejtje” për znj. R.Gj, për mosplotësim të ditarit të mësuesit. Referuar librit të protokollit të institucionit, rezulton se ankuesja nuk ka marrë dijeni për vendimin, pasi nuk ka firmë në librin e protokollit dhe nuk ka lajmërim marrje poste nga institucioni.

Me shkresën nr. 131, datë 29.06.2022, Drejtorja e shkollës ka marrë vendimin për dhënien e masës disiplinore “Paralajmërim për heqje nga puna” për znj. R.Gj, për mosrespektim të orarit (nuk është paguar për datat 01,02,03 qershor 2021 dhe 16,17,18 qershor 2022) dhe të etikës së veshjes. Me shkresën nr. 131/1, datë 29.06.2022, “Njoftim”, shkolla i ka dërguar ankueses kopje të procesverbalit të takimit nr. 128, datë 28.06.2022 dhe të Vendimit nr. 131, datë 29.06.2022. Referuar librit të protokollit të institucionit, rezulton se ankuesja nuk ka marrë dijeni për vendimin, pasi nuk ka firmë në librin e institucionit dhe nuk ka lajmërim marrje poste nga institucioni.

Nga aktet e administruara rezulton se në datë 15.09.2022, në mjediset e drejtorisë së shkollës, është zhvilluar një takim mes drejtoreshës së shkollës, ankueses dhe Komisionit të Etikës. Referuar procesverbalit të mbajtur, rezulton se drejtorja e shkollës është ankuar për veshjen e mësueses Znj. R.Gj. Referuar procesverbalit rezulton se mësuesja M.R ka kërkuar që komisioni ta diskutojë këtë çështje më vete pasi drejtoresha dhe ankuesja janë në konflikt, ndërsa kryetarja e komisionit Sh.B është shprehur se duhet të bëhet qortim për veshjen dhe të vendoset rregull i detyrueshëm, veshja e përparësës. Në përfundim komisioni ka marrë vendimin që mësueses Znj. R.Gj, ti jepet vërejtje për thyerje të kodit të etikës. Procesverbali nuk është zbardhur dhe nuk ka masë disiplinore nga Komisioni i Etikës.

Me shkresën nr. 166, datë 23.09.2022, Drejtorja e shkollës ka marrë vendimin për dhënien e masës disiplinore “Vërejtje” për znj. R.Gj, për mosdorëzim të ditarit në mënyrën e duhur sipas standardeve që duhet të respektojnë një mësues i arsimit profesional. Me shkresën nr. 167, datë

27.09.2022, “Dërgim vendimi”, shkolla i ka dërguar ankueses Vendimin nr. 166, datë 23.09.2022. Referuar librit të protokollit të institucionit, rezulton se ankuesja nuk ka marrë dijeni për vendimin, pasi nuk ka firmë në librin e institucionit dhe nuk ka lajmërim marrje poste nga institucioni. Me shkresën nr. 166/1, datë 26.09.2022, nga ana e Drejtores së shkollës, përgjegjëses së burimeve njerëzore dhe sekretares është mbajtur procesverbali, në të cilin shkruhet se ankuesja ka refuzuar të nënshkruajë njoftimin e bërë nga drejtorja e shkollës.

Me shkresën nr. 170, datë 03.10.2022, Drejtorja e shkollës i ka dërguar ankueses njoftim për zhvillimin e takimit për bisedim në lidhje me marrëdhëniet e punës.

Me shkresën nr. 178, datë 07.10.2022, ankuesja ka njoftuar drejtoreshën e shkollës se është vënë në dijeni të shkresës së mësipërme në datë 03.10.2022 dhe kjo ka qenë arsyeja që nuk është paraqitur në takim.

Me shkresën nr. 180, datë 11.10.2022, Drejtorja e shkollës ka njoftuar ankuesen për zhvillimin e takimit për bisedim në lidhje me marrëdhëniet e punës për në datë 14.10.2022.

Referuar procesverbalit nr. 189, datë 17.10.2022, rezulton se në datë 14.10.2022 është zhvilluar takimi mes drejtores së shkollës dhe ankueses, në prani të përgjegjëses së burimeve njerëzore dhe sekretares së shkollës, në të cilën ankuesja është shprehur se nuk është dakord me përmbajtjen e procesverbalit të zbardhur.

Me shkresën nr. 190, datë 18.10.2022, Drejtorja e shkollës ka njoftuar ankuesen për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës në përfundim të afatit dy mujor të njoftimit, me datë 23.12.2022, për arsye si më poshtë:

- Mos respektim i orarit në punë;
- Mos respektim i kodit të etikës;
- Mos plotësim të ditarit;
- Dorëzim të “ditarit të mësuesit” vetëm me temat mësimore;
- Paraqitje jo dinjitoze në pjesëmarrjen në një projekt të deleguar nga drejtorja e shkollës;
- Mos respektim i orës së mësimit, duke tjetërsuar orën e mësimit, në orë pastrimi mbeturinash;
- Mos respektim të orës së mësimit, duke nisur orën me vonesë deri në 10 minuta;
- Larguar jashtë vendit pa njoftim paraprak në drejtori, duke cënuar procesin mësimor.

Me shkresën nr. 31, datë 28.10.2022, znj. R.Gj është ankuar tek drejtorja e shkollës për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës dhe ka marrë përgjigje nga shkolla me shkresën nr. 197, datë 01.11.2022.

Me shkresën nr. 221, datë 23.12.2022, Drejtorja e shkollës ka nxjerrë vendimin për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës me ankuesen.

Komisioneri vlerëson se, marrëdhëniet kontraktuale ndërmjet punëdhënësit/Shkollës së Mesme Profesionale “Kolë Margjini” Shkodër dhe punëmarrësit/ankueses, i nënshtrohen përcaktimeve të akteve ligjore dhe nënligjore që normojnë këtë marrëdhënie. Në këtë kontekst, Komisioneri ka

analizuar bazën ligjore në të cilën është mbështetur punëdhënësi, për dhënien e masave disiplinore dhe ndërprerjen e marrëdhënieve të punës me subjektin ankues.

Nga deklaratimet e palëve dhe provat e depozituara pranë KMD-së, Komisioneri vlerëson se masat disiplinore: “Vërejtje” nr. 111, datë 26.05.2022; “Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna” nr. 131, datë 29.06.2022 dhe “Vërejtje” nr. 166, datë 23.09.2022, që kanë shërbyer për të marrë vendimin për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës për ankuesen, janë të pabazuara dhe të padrejta, për arsytet e poshtë cituara:

- Nuk është depozituar asnjë provë shkresore që të vërtetojë se ndaj ankueses është zbatuar procedura ligjore lidhur me vendimmarrjen e Komisionit të Etikës dhe Komisionit të Disiplinës, njoftimin e masave sipërcituar dhe për të siguruar të drejtën e ankueses për t’u njohur me pretendimet e provat e depozituara kundër saj, për t’u dëgjuar, mbrojtur e paraqitur prapësimet e provat në mbrojtje të vetes. Madje gjatë seancës dëgjimore Drejtorja e shkollës deklaroi se: *“Komisioni i Etikës dhe Komisioni i Disiplinës nuk pranuan që të zbardhnin procesverbalin e takimit, pasi thanë se komisionet përbëheshin nga katër anëtarë”*.
- Lidhur me vonesat në punë, evidentohet që punëdhënësi i është referuar vetëm pamjeve të kamerave dhe jo listë prezencës së personelit apo pyetjes së dezhurnit të shkollës, pasi evidentohet se ankuesja ka insistuar se ka qenë në punë në datat 16-17 qershor 2022, si dhe evidentohet se drejtorja ka sjellë në vëmendje një rast të ndodhur një vit më përpara, kur në procesverbalin datë 28.06.2022 ka përmendur se ankueses i janë hequr ditët e punës në datat 01-03 qershor 2021.
- Nga provat e sjella nga palët, nuk evidentohet se ankuesja ka pasur veshje jo etike apo më të ndryshme se disa punonjës të tjerë, apo që Komisioni i Etikës së shkollës të kishte evidentuar veshjen jo etike të ankueses.
- Nga provat e sjella nga palët, Komisioneri nuk është në gjendje të vlerësojë nëse ditari i mësueses ishte i paplotësuar apo të ishte me mangësi, pasi plotësimi i ditarit është një dokument profesional dhe shumë specifik, për më tepër që nuk mund të evidentohet se ditari ka qenë i firmosur apo jo, ka qenë i plotësuar si në vitin shkollor paraardhës apo jo.
- Për më tepër, duke qenë se drejtorja dhe ankuesja kanë qenë në konflikt/mosmarrëveshje prej disa muajsh, duhej që drejtorja e shkollës për marrjen e një vendimi të besueshëm dhe të paanshëm duhet të respektonte rregulloren e shkollës dhe ti ishte drejtuar për këshillim dhe vendimmarrje, Njësisë së Zhvillimit, Komisionit të Etikës dhe Komisionit të Disiplinës.

Komisioneri në mungesë edhe të provave e fakteve apo indicieve të tjera, ka krijuar dyshime të arsyeshme dhe bindje të brendshme lidhur me masat disiplinore të dhëna nga punëdhënësi, mbështetur në motivacionet e cituara më sipër.

Kodi i Punës, Kontrata Individuale e Punës/Kontrata Kolektive e Punës dhe aktet nënligjor të cilat në kuptim të përcaktimit të detyrimeve dhe gëzimit të të drejtave ndërmjet palëve kontraktuale

kanë fuqinë e ligjit, kanë përcaktuar në mënyrë të detajuar rastet se kur jepen masat disiplinore dhe procedurën që duhet ndjekur e zbatuar për dhënien e tyre.

Neni 37, i Kodit të Punës “Masa disiplinore”, ka specifikuar se: *“Masat disiplinore parashikohen kryesisht në kontratën kolektive të punës. Në çdo rast kontrata individuale duhet t’i referohet akteve përkatëse, lidhur me masat disiplinore. Procedura e shqyrtimit të masës disiplinore nga punëdhënësi duhet të garantojë të drejtën e punëmarrësit për t’u dëgjuar, mbrojtur, parashtruar fakte dhe prova, brenda një afati të arsyeshëm”.*

Neni 13<sup>6</sup>, i Kontratës Kolektive të Punës<sup>7</sup> ka përcaktuar se, në rast të shkeljeve disiplinore, ndaj punëmarrësit merren masat disiplinore të mëposhtme:

- Vërejtje me shkrim;
- Vërejtje me paralajmërim për pushim nga puna;
- Zbritje në detyrë në një cikël më të ulët për një periudhë deri në 1 (një) vit;
- Largim nga puna.

Ky nen ka parashikuar se: *“Në varësi të shkeljes përcaktohet edhe masa disiplinore....*

*...procedura disiplinore garanton të drejtën e punonjësit për t’u njoftuar lidhur me fillimin e procedimit, të drejtën për t’u dëgjuar, për të paraqitur prova, si dhe të drejtën për t’u ankuar ndaj vendimit përfundimtar”.*

Parashikimet ligjore sipërcituar janë shkelur e keq zbatuar në këtë rast nga punëdhënësi lidhur me dhënien e masave disiplinore: “Vërejtje” nr. 111, datë 26.05.2022; “Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna” nr. 131, datë 29.06.2022 dhe “Vërejtje” nr. 166, datë 23.09.2022, për ankuesen, pasi asaj nuk i është garantuar e drejta për t’u njohur e vënë në dijeni me faktin se ndaj saj kishte filluar një ecuri disiplinore, e drejta për t’u dëgjuar, mbrojtur, parashtruar fakte dhe prova në favorin e vet apo për ti kundërshtuar në gjykatë.

Dhënia e masave disiplinore është pjesë e mjeteve ligjore për mbrojtjen e punëdhënësit, në rastet kur punëmarrësi nuk i respekton rregullat dhe normat kontraktore dhe ligjore. Masat disiplinore duhet të jepen duke respektuar parimin e proporcionalitetit, që parashikon se për një shkelje të lehtë, duhet të jepet masë disiplinore e lehtë e më tej duke u përshkallëzuar. Masa disiplinore duhet të dokumentohet, të materializohet dhe t’i bëhet me dije punëmarrësit në kohën kur jepet, sepse ai ka të drejtën e ankimit ndaj masës, si dhe për faktin se masat disiplinore më të lehta parashkruhen me kalimin e afateve të caktuara ligjore.

Në rast se do të kishte ndjekur e respektuar një procedurë të tillë, Shkolla, duhet të kishte pasur në konsideratë zbatimin e parimit të kontradiktoritetit, si një garanci që punëmarrësit duhet t’i ishin krijuar mundësitë për t’u mbrojtur *efektivisht* për kundërshtimin e masave të dhëna ndaj saj.

---

<sup>6</sup> Masat disiplinore.

<sup>7</sup> Kontratë e lidhur midis AKPA dhe Konfederatës së Sindikatave të Shqipërisë (KSSH) me datë 22.09.2020, me afat 3 (tre) vjeçar.

Shkelja e këtij parimi përbën shkelje të së drejtës themelore për një proces të rregullt ligjor, garantuar nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut, qëndrim ky i konsoliduar tashmë në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese dhe GJEDNJ.

Gjykata Kushtetuese, në vendimin nr. 69 dt.16.10.2000 të saj, ka mbajtur qëndrimin se: *“Parimi i kontradiktoritetit lidhet e me të drejtën e palëve për t’u dëgjuar, për t’i bërë të njohur njëra tjetrës mjetet dhe faktet mbi të cilat i mbështetin të gjitha pretendimet e tyre, provat e grumbulluara, referencën e saktë ligjore”*.

Lidhur me masën e dhënë ndaj ankueses *“Për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës”*, Komisioneri nuk ka analizuar faktin nëse ajo është e drejtë, e bazuar dhe e ligjshme, pasi:

- Marrja e kësaj mase disiplinore ka ardhur si rezultat i shkeljes së garancisë ligjore të ankueses lidhur me zhvillimin e një procesi të rregullt e të drejtë, lidhur me masat disiplinore në të cilin u bazua largimi nga puna i ankueses, duke i mohuar të drejtën për t’u njohur, dëgjuar, mbrojtur efektivisht, si palë e cënuar në këtë proces.

Procedura e ndjekur për dhënien e masës disiplinore, për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës, dhe vetë masa janë në kundërshtim me sa parashikohet në aktet rregulluese për dhënien e masave disiplinore nga punëdhënësi ndaj punëmarrësit.

Marrëdhëniet e punës mes ankueses dhe punëdhënësit, në këtë rast Shkollës, rregullohen nga një kuadër ligjor i mirë përcaktuar.

Shkolla e Mesme Profesionale “Kolë Margjini” Shkodër si ofrues publik në sistemin arsimor të Arsimit dhe Formimit Profesional (AFP) ushtron veprimtarinë e saj në përputhje me ligjin nr. 15/2017 *“Për Arsimin dhe Formimin Profesional në Republikën e Shqipërisë”* dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin nr. 69/2012 *“Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”*, të ndryshuar dhe aktet e tjera nënligjore në zbatim të tij.

Vendimi për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës me ankuesen është marrë për arsye të shkeljeve të përsëritura, si më poshtë: - Mos respektim i orarit në punë; - Mos respektim i kodit të etikës; - Mos plotësim të ditarit; - Dorëzim të “ditarit të mësuesit” vetëm me temat mësimore; - Paraqitje jo dinjitoze në pjesëmarrjen në një projekt të deleguar nga drejtoria e shkollës; - Mos respektim i orës së mësimi, duke tjetërsuar orën e mësimi, në orë pastrimi mbeturinash; - Mos respektim të orës së mësimi, duke nisur orën me vonesë deri në 10 minuta; - Larguar jashtë vendit pa njoftim paraprak në drejtori, duke cënuar procesin mësimor.

Në këtë kuadër, dhënia e masave disiplinore për punonjësit e AFP-ve, që kanë të bëjnë specifikisht me shkelje të etikës e disiplinës në punë, është e rregulluar me aktet nënligjore si: Udhëzimi nr. 14, datë 27.05.2021 *“Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë së institucioneve të Arsimit dhe Formimit Profesional, si dhe aspektet e menaxhimit të burimeve njerëzore, përbërjes së njësisë së zhvillimit të ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit”*, të MFE, Urdhrit të Brendshëm nr. 88, datë 13.04.2021 *“Për miratimin e Kodit të*

Etikës në AKPA”, “Rregulloren e Brendshme 2021-2022, të Shkollës Teknike Pyjore “Kolë Margjini” Shkodër”, “Rregulloren e Brendshme të Shkollës Teknike Pyjore “Kolë Margjini” Shkodër”, të miratuar me Vendimin nr. 46, datë 05.09.2022 të Bordit Drejtues, si dhe Kodit të Etikës të shkollës të miratuar me vendimin e Bordit Drejtues/Drejtorit të institucionit me datë 05.09.2022.

Kështu, ligji 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në RSH”, i ndryshuar, në nenin 33 të tij ka përcaktuar se: “Në institucionin arsimor funksionon komisioni i etikës dhe sjelljes, i përbërë nga mësues, prindër dhe nxënës. Komisioni ka për detyrë të shqyrtojë ankesat e nxënësve, të prindërve e të punonjësve të institucionit ndaj shkeljeve të normave të etikës dhe të sjelljes dhe t'i propozojë drejtorit të institucionit masat përkatëse”.

Neni 52<sup>8</sup> i Udhëzimit nr. 14, datë 27.05.2021 “Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë së institucioneve të Arsimit dhe Formimit Profesional, si dhe aspektet e menaxhimit të burimeve njerëzore, përbërjes së njësisë së zhvillimit të ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit”, të MFE-së, ka përcaktuar se:

“2. Sjellja etike e punonjësit të ofruesit të AFP-së është në funksion të përmbushjes së pritshmërive të nxënësve/kursantëve, personave që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore të tyre, partnerëve të shkollës, ku përmbushja e detyrimeve ndaj tyre është mbi interesat e çdo punonjësi arsimor. ....

4. Punonjësi i ofruesit të AFP-së ka detyrim që, gjatë veprimtarisë së tij, të zbatojë standardet dhe kërkesat etike në nivelin që kërkohet në Kodin Etikës. Devijimet nga niveli i kërkuar në Kodin e Etikës konsiderohen shkelje të këtij kodi. ....

7. Punonjësi i ofruesit të AFP-së zbaton rregullat e etikës kur:

a) respekton në frymë dhe në germë detyrimet ligjore e kontraktuale;

j) ka një veshje dhe paraqitje serioze që i përgjigjet funksionit dhe natyrës së punës, qoftë si punonjës i ofruesit të AFP-së ose nxënës/kursant. Nuk lejohen veshje që ekspozojnë trupin;

Neni 53, i Udhëzimit sipërcituar, ka përcaktuar procedurën e rregullat për ngritjen e funksionimit e Komisionit të Etikës dhe Sjelljes në ofruesin e AFP-së:

“1. Në çdo ofrues të AFP-së, i cili ofron arsim të mesëm profesional ngrihet dhe funksionon komisioni i etikës dhe sjelljes, në përputhje me nenin 33, të ligjit 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

2. Drejtori i ofruesit të AFP-së, në çdo fillim viti shkollor, organizon procesin dhe miraton ngritjen e komisionit të etikës dhe sjelljes. ....

5. Në ofruesit e AFP-së me më pak se 24 klasa, komisioni përbëhet nga pesë anëtarë, kurse në ato me të paktën 24 klasa përbëhet nga shtatë anëtarë. ....

<sup>8</sup> Kreu XII “Komisioni i Etikës dhe Sjelljes në ofruesit e AFP-së që ofrojnë arsim të mesëm profesional”.



11. Drejtori nuk bën pjesë në Komision”.

Neni 56 i këtij Udhëzimi rregullon veprimtarinë e Komisionit të Etikës e Sjelljes, duke përcaktuar se: “1. Komisioni i Etikës mbikëqyr zbatimin e Kodit të Etikës së ofruesit të AFP-së dhe propozon pasurim të tij. ....

4. Komisioni, me iniciativën e tij, mund të trajtojë raste për shkelje të etikës të kryera nga punonjësi i ofruesit të AFP-së, të cilat janë në kundërshtim me rregullat e parashikuara në Kodin e Etikës dhe në aktet e tjera në fuqi. Propozimin e tij për masë disiplinore, komisioni e përcjell te drejtori i ofruesit të AFP-së për t’u trajtuar në komisionin e disiplinës.

5. Komisioni ka të drejtë të thërrasë palët për t’i ballafaquar. ....

7. Komisioni shqyrton dhe gjykon në bazë të fakteve e provave të administruara në seancën dëgjimore për palën ndaj së cilës propozohet masa disiplinore. Në rastet kur vërtetohet se pala ka kryer shkelje të etikës dhe rregullores së ofruesit të AFP-së, përveç rasteve kur ato përbëjnë vepër penale, komisioni propozon masa disiplinore sipas akteve ligjore e nënligjore në fuqi.

8. Komisioni, në përfundim të shqyrtimit të ankesës i propozon drejtorit të ofruesit të AFP-së masën disiplinore për çështjet e ngritura në ankesë, në përputhje me parashikimet e rregullores. Vendimmarrja i takon Komisionit të Disiplinës.

9. Komisioni njofton palët për përfundimin e shqyrtimit të ankesës dhe vë në dispozicion vendimin bashkë me arsyetimin përkatës, sipas shtojcës 10 të këtij udhëzimi”.

Në funksion të zbatimit të legjislacionit të sipërcituar në Shkollën “Kolë Margjini”, janë ngritur Komisionet si më poshtë:

- Me shkresën nr. 148, datë 19.10.2021, Urdhër nr. 7, datë 19.10.2021, është urdhëruar ngritja e Komisionit të Etikës dhe Sjelljes në Shkollën e Mesme Profesionale “Kolë Margjini” Shkodër, për vitin shkollor 2021-2022, të përbërë nga 4 anëtarë: E.B, psikologe, M.R, mësuese, R.Sh, prind dhe F.L, nxënës.
- Me shkresën nr. 112, datë 10.09.2021, Urdhër nr. 6, datë 10.09.2021, është urdhëruar ngritja e Komisionit të Disiplinës në Shkollën e Mesme Profesionale “Kolë Margjini” Shkodër, për vitin shkollor 2021-2022, të përbërë nga 4 anëtarë: A.LI, Drejtore (Kryetare), B.B, Përgjegjëse e Njësisë së Zhvillimit, R.Gj, mësuese dhe D.K, Kryetar i Qeverisë së Nxënësve.
- Me shkresën nr. 47, datë 20.09.2022, Urdhër nr. 7, datë 20.09.2022, është urdhëruar ngritja e Komisionit të Etikës dhe Sjelljes në Shkollën e Mesme Profesionale “Kolë Margjini” Shkodër, për vitin shkollor 2022-2023, të përbërë nga 5 anëtarë: E.B, psikologe, C.K, mësuese, R.Sh, prind, F.L, nxënës dhe A.P, nxënës.
- Me shkresën nr. 45, datë 20.09.2022, Urdhër nr. 39, datë 20.09.2022, është urdhëruar ngritja e Komisionit të Disiplinës në Shkollën e Mesme Profesionale “Kolë Margjini”

Shkodër, për vitin shkollor 2022-2023, të përbërë nga 5 anëtarë: A.LI, Drejtore (Kryetare), M.S, mësues, K.M, mësues, D.B, mësues dhe A.O, mësues.

Drejtori<sup>9</sup> është përfaqësuesi ligjor i ofruesit të AFP-së dhe drejton veprimtarinë e tij. Drejtori kryen çdo detyrë që lidhet me funksionin e tij, ndër të tjera edhe garantimin e ngritjes e funksionimit të këshillave, komisioneve dhe grupeve të brendshme të punës në ofruesin e AFP-së (përfshirë këtu edhe ngritjen e Komisionit të Etikës dhe Komisionit të Disiplinës në Shkollë). Kjo kompetencë e detyrim ligjor i Drejtorit të Shkollës evidentohet edhe në “Rregulloren e Brendshme të Shkollës “Kolë Margjini” Shkodër”, ku përcaktohet se:

*“Neni 22. Drejtori i institucionit është përfaqësuesi ligjor i Shkollës dhe drejton veprimtarinë e tij.*

*Neni 23. Drejtori kryen çdo detyrë që lidhet me funksionin e tij si më poshtë: ... c) monitoron dhe vlerëson performancën e stafit; .... p) garanton ngritjen dhe funksionimin e këshillave, komisioneve dhe grupeve të brendshme të punës në institucion”.*

Në nenet 12 dhe 13, të kësaj Rregulloreje është përcaktuar përbërja<sup>10</sup> e Komisionit të Etikës dhe funksionet e detyrat e tij.

Funksionet dhe detyrat e Komisionit të Etikës e Sjelljes<sup>11</sup> janë:

*“a) trajton të gjitha ankesat që i paraqiten me shkrim brenda objektit të veprimtarisë së tij;*

*b) shqyrton dhe gjykon në bazë të fakteve e provave të administruara në seancën dëgjimore për palën ndaj të cilës propozohet masa disiplinore;*

*c) në përfundim të shqyrtimit të ankesës i propozon drejtorit të ofruesit të institucionit masën disiplinore për çështjet e ngritura në ankesë, në përputhje me parashikimet e rregullores; .....*”.

Në nenet 14 dhe 15, të kësaj Rregulloreje është përcaktuar përbërja<sup>12</sup> e Komisionit të Disiplinës dhe funksionet e detyrat e tij.

Funksionet dhe detyrat e Komisionit të Disiplinës janë:

*“Komisioni shqyrton dhe miraton shkelje të disiplinës në marrëdhëniet e punës të personelit të institucionit, procesit mësimor si dhe veprimtarisë së nxënësve të institucionit brenda procesit të institucionit. Komisioni shqyrton rastet e paraqitura para tij nga subjektet e legjitimuara dhe rast pas rasti propozon masat disiplinore të parashikuara në këtë rregullore stafit drejtues të institucionit.*

*Komisioni i disiplinës shqyrton rastet e konstatuara nga komisioni i etikës dhe i sjelljes për shkeljet disiplinore të kryera nga ana e nxënësve, mësuesve dhe nëndrejtorëve. Komisioni angazhohet të*

<sup>9</sup> Neni 22, i këtij Udhëzimi.

<sup>10</sup> Komisioni i Etikës e Sjelljes përbëhet nga 5 (pesë) deri në 7 (shtatë), të përbërë nga mësues, nxënës dhe persona që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore.

<sup>11</sup> Neni 13, i Rregullores.

<sup>12</sup> Komisioni i Disiplinës ngrihet çdo fillim të vitit shkollor dhe përbëhet nga 5 (pesë) deri në 7 (shtatë) persona.

mbikëqyr zbatimin me përpikëri të disiplinës në marrëdhëniet e punës dhe në procesin mësimor dhe praktikë brenda institucionit”.

Në nenin 73 të Rregullores “Masat disiplinore për personelin mësimdhënës”, përcaktohet se:

“1. Komisioni i disiplinës i institucionit jep masën disiplinore për punëmarrësin kur:

- a) Konstaton shkelje të legjislacionit në fuqi për arsimin dhe formimin profesional dhe arsimin parauniversitar ose të rregullores së brendshme të institucionit;
- b) Konstaton shkelje të dispozitave të Kodit të Etikës e të sjelljes në institucion;
- c) .....
- d) Konstaton mësuesi/nëndrejtori nuk kryen detyrat e tij sipas përshkrimit të tij të punës.

2. Masat e përshkallëzuara që komisioni i disiplinës vendos për punëmarrësin, në varësi të llojit të shkeljes apo përsëritjes së të njëjtës shkeljeje, janë:

- a) qortim; b) vërejtje; c) paralajmërim për largim nga puna; d) largim nga puna.

3. Në rastin e përsëritjes së shkeljes nga punëmarrësi, i cili për atë shkelje ka marrë më parë masën “Paralajmërim për largim nga puna”, komisioni i disiplinës i propozon drejtorit të institucionit fillimin e procedurave për largimin nga puna të mësuesit.

4. Vërejtja është e shlyer kur për një periudhë gjashtëmuajore komisioni i disiplinës nuk ka shqyrtuar shkelje tjetër të punëmarrësit”.

Kodi i Etikës i institucionit “Shkolla teknike pyjore, Shkodër”, miratuar nga Bordi Drejtues/Drejtori i institucionit me datë 05.09.2022, është i detyrueshëm për zbatim nga të gjitha njësitë përbërëse dhe organizative të institucionit dhe nga gjithë personeli dhe ka për qëllim të vendosë rregulla për sjellje profesionale të anëtarëve të institucionit dhe të përcaktojë parimet e etikës në procesin mësimor dhe jetës publike<sup>13</sup>.

Në nenin 5 të këtij Kodi “Detyrimet e punonjësve”, parashikohet se: “Çdo punonjës i institucionit, gjatë kryerjes së detyrës duhet të udhëhiqet nga parimet e përcaktuara në nenin 3 dhe në vazhdimësi të angazhohet që: ..... 11) Të respektojë orarin e punës të vendosur në marrëveshje me punëdhënësin ose eprorin; ... 13) Të ruaj një paraqitje serioze gjatë orarit të punës, që përfshijnë veshje serioze e dinjitoze; ... 15) Të zbatojë me korrektësi detyrën dhe urdhrat e eprorit në përputhje me aktet ligjore e nënligjore”.

Në nenin 17 të këtij Kodi, “Format e komunikimit me shkrim”, përcaktohet se: “Komunikimi me shkrim është i domosdoshëm për të siguruar një komunikim etik brenda institucionit dhe për të shmangur keqkuptimet që mund të lindin si pasojë e komunikimit verbal. Format e komunikimit me shkrim janë dy: në formë shkresore dhe elektronike”.

<sup>13</sup> Nenet 1, 2, 3, të Kodit të Etikës.

Në nenin 20 të Kodit të Etikës, “Llojet e masave”, parashikohet se: “Në rast shkelje të Kodit të Etikës nga ana e personelit mësimor të dispozitave normative të parashikuara në aktet ligjore e nënligjore në fuqi, të dispozitave të rregullores, si dhe të normave të etikës, merren masat e mëposhtme: a) tërheqje vëmendje; b) vërejtje me shkrim; c) vërejtje me paralajmërim; d) pezullim nga detyra; e) largim nga detyra. ....

*Masat e përcaktuara në këtë nen jepen në formë rekomandimi nga Komisioni i Etikës dhe Sjelljes në proporcion me shkeljen e kryer dhe i përcillen për miratim Komisionit Disiplinor i cili në çdo rast ka të drejtën e vendimmarrjes përfundimtare”.*

Në nenin 22 të Kodit të Etikës, “Komisioni i Etikës dhe Sjelljes”, parashikohet se: “Komisioni i Etikës dhe Sjelljes do të jetë përgjegjës për zhvillimin e procedurave të cilat lidhen me çështjen e etikës që do të shoqërojnë këtë Kod të Etikës duke përfshirë edhe të drejtën për të organizuar seanca dëgjimore për secilin person të akuzuar për shkelje të këtij Kodi dhe për të propozuar sanksione për rastet e shkeljes së këtij Kodi”.

Referuar sa më lart, në analizë të legjislacionit sipërcituar, Komisioneri vlerëson se, procedura e ndërmarrë nga ana e Drejtores së Shkollës, lidhur me dhënien e masave disiplinore, vërejtje, vërejtje me paralajmërim nga puna dhe ndërprerja e marrëdhënieve të punës me motivacion shkelje të etikës dhe disiplinës në punë, është haptazi në shkelje të dispozitave ligjore që rregullojnë e normojnë marrëdhëniet e punës të cituar më sipër: punëmarrës-punëdhënës.

Pra, referuar sa më sipër, Komisioneri vlerëson se organi që ka kompetencën kryesore për vlerësimin etik dhe profesional të mësuesit/ankueses dhe propozimin e masës, bazuar në KES, e ka Komisioni i Etikës dhe Sjelljes që duhet të ishte ngritur sipas parashikimeve ligjore me pesë anëtarë, në fillim të viti shkollor 2020-2021. Ndërsa Komisioni i Disiplinës ka të drejtën që të vlerësojë propozimin e Komisionit të Etikës dhe të rekomandojë masën disiplinore.

Në këtë kontekst, Komisioneri gjykon se, Drejtori i Shkollës, në rastin konkret, pretendimet për shkelje të etikës, sjelljes e profesionalizmit nga ana e ankueses, duhet t’i kishte referuar pranë këtyre komisioneve kompetente për shqyrtimin e sjelljeve të punonjësve të institucionit, veprime që janë bërë në kundërshtim me parashikimet e Rregullores së Brendshme dhe të Kodit të Etikës nga Drejtori i Shkollës.

*Lidhur me sa më sipër, Komisioneri vlerëson se:*

Drejtori i Shkollës, në shkelje të pikës 2, të nenit 53, të Udhëzimit nr. 14, datë 27.05.2021 “Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë së institucioneve të Arsimit dhe Formimit Profesional, si dhe aspektet e menaxhimit të burimeve njerëzore, përbërjes së njësisë së zhvillimit të ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit”; nuk ka ngritur Komisionin e Etikës dhe Komisionin e Disiplinës sipas parashikimeve të këtij udhëzimi, të cituara më lart si dhe nuk ka ndjekur procedurën ligjore lidhur me funksionimin e këtyre komisioneve për shqyrtimin e rastit të subjektit ankues.

Motivacioni dhe shkeljet e pretenduara nga Drejtori i Shkollës, të cilat kanë shërbyer si shkak për lirim e ankueses nga detyra, janë elementë të parashikuar në Kodin e Etikës dhe Sjelljes (sipërcituar) dhe si të tilla, kompetencën për shqyrtimin e vlerësimin e tyre e ka Komisioni i Etikës e Sjelljes (KES) dhe jo Drejtori, sikundër ka vepruar në rastin konkret.

Rezulton se Komisioni i Etikës dhe Sjelljes dhe Komisioni i Disiplinës nuk kanë shqyrtuar ndonjë ankesë kundrejt ankueses apo të ketë dalë me ndonjë propozim apo vendimmarrje për të.

Në këtë kontekst, Komisioneri gjykon se, pa marrë në konsideratë faktin nëse pretendimet e punëdhënësit kundrejt ankueses qëndrojnë apo jo, shkelja e procedurës dhe tejkalimi i kompetencës për dhënien e masave ndaj saj, kanë cënuar rëndë të drejtat e saj si punëmarrëse për një proces të rregullt, të drejtë e ligjor.

**Në përfundim, bazuar në analizimin e veprimeve të Drejtores së Shkollës së Mesme Pyjore “Kolë Margjini” Shkodër, kundrejt mësueses znj. R.Gj, bazës ligjore tek e cila janë referuar masat disiplinore kundrejt saj, përfshirë edhe zgjidhjen e marrëdhënieve të punës me të, Komisioneri vlerëson se, subjekti ankues i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe të pafavorshëm, nga ana e punëdhënësit.**

## **B. Shkaku i mbrojtur.**

Në ankesën objekt shqyrtimi, ankuesja Znj. R.Gj pretendon se është diskriminuar për shkak të “*bindjeve politike*”.

Bazuar në shkaqet e mbrojtura të përcaktuara në nenin 1, të LMD, si dhe duke ju referuar përkufizimit të diskriminimit që ligji ka bërë në nenin 3, të tij, jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim më pak i favorshëm gëzon mbrojtje nga ligji. Mbrojtja nga diskriminimi sipas ligjit, garantohet vetëm për, ato diferenca në trajtim apo trajtime më pak të favorshme, që kanë për bazë një nga shkaqet e mbrojtura.

Sa më sipër, në radhë të parë shkaku i pretenduar si diskriminues nga pala ankuese duhet të parashikohet nga ligji si i tillë dhe në radhë të dytë, pala ankuese duhet të provojë se e posedon shkahun e pretenduar.

*Në lidhje me shkahun e bindjeve politike*, ankuesja pretendon se është diskriminuar për shkak të bindjeve politike, duke pretenduar se marrëdhëniet e saj të punës pranë Shkollës së Mesme Pyjore “Kolë Margjini” Shkodër, janë ndërprerë pasi është anëtare dhe aktiviste e Partisë Demokratike të Shqipërisë dhe vjen nga një familje e cila njihet për aktivistë të Partisë Demokratike në qytetin e Lezhës. Kunati i saj Gj. Gj, në zgjedhjet vendore të vitit 2003, 2007 dhe 2011 ka qenë Kryetar i Komunës Ungrej, në Qarkun Lezhë nën siglën e PD<sup>14</sup>, si dhe fëmijët janë anëtarë të FRPD Lezhë.

---

<sup>14</sup> Referuar rezultateve të publikuara në faqen e internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Komisioneri vlerëson se, shkak i bindjeve politike i pretenduar nga ankuesja si shkak diskriminues, gëzon mbrojtje nga neni 1, i LMD. Mbrojtja nga diskriminimi për shkak të bindjeve politike garantohet edhe nga neni 9, pika 2, të Kodit të Punës.

Në lidhje me shkakun e bindjeve politike, Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë, në vendimin nr. 31/2021, në pikën 67, të tij, shprehet se: *“...nacioni bindje politike përfshin jo vetëm shprehjen e pikëpamjeve politike dhe pjesëmarrjen në debatin politik apo inkuadrimin, organizimin kolektivisht ose pjesëmarrjen në organizata apo parti politike, por edhe të drejtën për të pasur ide ose pikëpamje që nuk bëjnë pjesë në ndonjë platformë apo program të partive politike, si dhe të drejtën për të mos iu bashkuar strukturave të organizatave ose partive politike”*.

Referuar Vërtetimit nr. 36, datë 10.12.2022 të lëshuar nga Partia Demokratike Dega Lezhë, vërtetohet se ankuesja në zgjedhjet e datës 25.04.2021, ka qenë anëtare në Qendrën e Votimit nr. 740, KZAZ nr. 12, Qarku Lezhë.

Referuar Vërtetimit nr. 1 dhe nr. 2, datë 15.11.2022, të lëshuar nga Kryetari i Forumit Rinor të Partisë Demokratike, vërtetohet se dy fëmijët e ankueses, janë anëtarë të FRPD.

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson të provuar shkakun e pretenduar të diskriminimit, nga ana e subjektit ankues, atë të *“bindjes politike”*.

### **C. Lidhja e trajtimit të padrejtë dhe të pafavorshëm me shkakun e mbrojtur.**

Në kontekst të mbrojtjes ligjore që i garantohet individit lidhur me këtë shkak, Komisioneri është mbështetur në analizimin e legjislacionit kombëtar dhe atij ndërkombëtar, lidhur me këtë fakt.

Parimi i barazisë dhe i mosdiskriminimit, sanksionohet nga Kushtetuta si një parim i përgjithshëm që përshkon të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj ai duhet të gjejë shprehjen e tij në të gjithë legjislacionin shqiptar si dhe të zbatohet nga të gjithë, si nga institucionet edhe nga individët. Ky parim përshkon edhe nenin 49 të Kushtetutës sipas të cilit *“Secili ka të drejtë të fitojë mjetet e jetesës së tij me punë të ligjshme që e ka zgjedhur ose pranuar vetë. Ai është i lirë të zgjedhë profesionin, vendin e punës, si dhe sistemin e kualifikimit të vet profesional”*.

Sipas nenit 116 të Kushtetutës, marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara me ligj, në hierarkinë e normave juridike renditen menjëherë pas Kushtetutës. Për pasojë, ato zënë një vend të rëndësishëm në të drejtën e brendshme e bëhen të detyrueshme për t'u zbatuar për çdo shtet, për të gjithë organet shtetërore.

Shqipëria ka nënshkruar e ratifikuar disa akte ndërkombëtare, që në thelb kanë të bëjnë me trajtimin e barabartë, mosdiskriminimin, mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në përgjithësi, ndër të cilat është edhe Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut, e cila jo vetëm që është pjesë e e legjislacionit të brendshëm të Republikës së Shqipërisë, por zë një vend të veçantë brenda tij. Konventa njih dhe parashikon kufizime të përgjithshme dhe kufizime specifike për të drejta të veçanta. Neni 14 i Konventës garanton barazinë *“në gëzimin e të drejtave dhe lirive”* të përcaktuara në të. Protokollin 12-të i saj ndalon diskriminimin në lidhje me

“gëzimin e çdo të drejte të parashtruar nga ligji” dhe kështu ofron mbrojtje më të madhe në fushëveprimin e tij sesa Neni 14, i cili lidhet vetëm me të drejtat e garantuara nga KEDNJ-ja.<sup>15</sup>

Njëkohësisht, eliminimi i diskriminimit u ripohua si një kriter i pandarë i çdo politike të ILO-s<sup>16</sup> që prej adoptimit në vitin 1998 të “Deklaratës së ILOS mbi kriteret themelore dhe të Drejtat në Punë”. Kjo Deklaratë përcakton se të gjitha të drejtat themelore të njeriut duke përfshirë edhe eliminimin e diskriminimit përsa i përket punësimit dhe profesionit janë shumë të domosdoshme për mandatin e ILO-s. Në Deklaratë citohet se anëtarësia në Organizatë nga një shtet krijon në vetvete një detyrim për të promovuar këto të drejta edhe sikur shteti të mos këtë ratifikuar Konventat Themelore që parashtrjnë këto kritere.

Karta Sociale Europiane<sup>17</sup> parashikon si detyrim të të gjithë vendeve nënshkruese përmbushjen dhe zbatimin e disa parimeve. Në pjesën e parë të kësaj Karte parashikohet: *“Palët pranojnë si synim të politikës së tyre, që do të ndiqet me të gjitha mjetet e përshtatshme, si të karakterit kombëtar, ashtu edhe ndërkombëtar, arritjen e kushteve në të cilat të drejtat dhe parimet e mëposhtme mund të realizohen në mënyrë efektive: Cilido do të ketë mundësinë të fitojë jetesën e tij në një punë në të cilën ka hyrë lirisht”*.

Kodi i Punës, i ndryshuar, në nenin 9, të tij ka parashikuar se: *“Në ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion, ndalohet çdo formë diskriminimi, e parashikuar në këtë Kod dhe në legjislacionin e posaçëm për mbrojtjen nga diskriminimi”*. Ndërsa pika 5, germa c) e tij parashikon se: *“Në kuptim të këtij neni, ndalimi i diskriminimit dhe zbatimi i parimit të trajtimit të barabartë në ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion zbatohet në lidhje me: ..... c) kushtet e punës dhe punësimit, përfshirë zgjidhjen e kontratës së punës dhe pagën”*.

Ky parashikim është në të njëjtën frymë me parashikimet ligjore të LMD-së. Ligji 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar, është një ligj që rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë, si dhe përcakton shkaqet për të cilat ky ligj ofron mbrojtje. Gjithashtu në nenin<sup>18</sup> 12/1/c) të ligjit 10221/2010, të ndryshuar, parashikohet se ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën për punësim, për shkaqet e parashikuara në nenin 1.

Parimi i ndarjes së barrës së provës është shumë i ngjashëm me atë të supozimeve të marra si të vërteta deri në vërtetimin e të kundërtës - *“praesumptio iuris tantum”*.

Në shumicën e çështjeve të diskriminimit, ankuesi e ka të vështirë apo të pamundur t’i mbledhë provat, ndonjëherë provat e drejtpërdrejta as nuk ekzistojnë. Subjektet që konsumojnë sjelljen diskriminuese nuk e pranojnë asnjëherë se kanë diskriminuar. Për të kompensuar këtë disavantazh

<sup>15</sup> [https://www.echr.coe.int/Documents/Handbook\\_non\\_discrimination\\_law\\_SQL.pdf](https://www.echr.coe.int/Documents/Handbook_non_discrimination_law_SQL.pdf), faqet 47 dhe 49.

<sup>16</sup> International Labor Organization (Organizata Botërore e Punës)

<sup>17</sup> Ratifikuar me ligjin Nr. 8960, date 24.10.2002.

<sup>18</sup> Ligji 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar, në nenin 12/1/c, parashikon se: *“Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me:...c) trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimin, përfitimet dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës”*

të madh, legjislacioni ka parashikuar parimin e zhvendosjes së barrës së provës. Parimi i zhvendosjes së barrës së provës është një parim i konsoliduar në legjislacionin e BE-së dhe jurisprudencën e GJEDNJ-së. KEDS<sup>19</sup> gjithashtu ka pranuar që në çështjet e diskriminimit, barra e provës nuk duhet të varet plotësisht nga ankuesi, por duhet të jetë objekt i një rregullimi të posaçëm.

Kodi i Procedurës Administrative, i ndryshuar<sup>20</sup> ka saktësuar se barra e provës në çështjet e diskriminimit të pretenduar, i kalon palës tjetër, në këtë rast Shkollës Profesionale “Kolë Margjini”, e cila duhet të provonte se subjekti ankues nuk është trajtuar në mënyrë të pafavorshme, për shkakun e pretenduar prej saj.

Ky rregullim i posaçëm në lidhje me barrën e provës, pasqyrohet në nenin 33, pika 7/1 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ku parashikohet se: “7/1. Në rastet kur pala ankuese paraqet fakte mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër, kundër së cilës është paraqitur ankesa, detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim.”

Duke qenë se pala kundër të cilës drejtohet ankesa disponon gjithë informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm për të provuar bazueshmërinë e pretendimeve, legjislacioni i ka transferuar barrën e provës palës kundër të cilës është paraqitur ankimi, kur vihet re se *prima facie* është ngritur një pretendim për diskriminim. Pala kundër të cilës është paraqitur ankesa ka barrën e provës të provojë se trajtimi i diferencuar nuk është diskriminues.

Sa më sipër, ankuesi duhet të krijojë një prezumim të diskriminimit (diskriminimi *prima facie*), barra më pas kalon tek subjekti kundër të cilit drejtohet ankesa, i cili duhet të tregojë se ndryshimi në trajtim nuk është diskriminues. Kjo mund të bëhet:

1. Ose duke vërtetuar se nuk ka ndonjë lidhje shkakësore midis shkakut të mbrojtur dhe trajtimit të pafavorshëm apo të pabarabartë.
2. Ose duke demonstruar që megjithëse ky trajtim është i lidhur me shkakun e pretenduar, ka një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv. Nëse subjekti, i cili pretendohet se ka konsumuar sjelljen diskriminuese nuk është në gjendje të provojë një të dyja, atëherë do të jetë përgjegjës për diskriminimin.<sup>21</sup>

Sa i takon rastit në fjalë, KMD bazuar në shqyrtimin e fakteve dhe provave të ankuesit, si dhe ato që dolën nga procedura e shqyrtimit të ankesës ka arritur në përfundimin që kemi të bëjmë me një trajtim të padrejtë dhe të pafavorshëm të saj, nga ana e Drejtores së Shkollës Profesionale “Kolë

<sup>19</sup> Komiteti Evropian për të Drejtat Sociale.

<sup>20</sup> Kështu, neni 82, pika 2 e tij, përcakton se: “Në rastet kur pala paraqet prova mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër dhe/ose organi publik detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj”.

<sup>21</sup> [https://fra.europa.eu/sites/default/files/fra\\_uploads/fra-2018-handbook-non-discrimination-law-2018\\_en.pdf](https://fra.europa.eu/sites/default/files/fra_uploads/fra-2018-handbook-non-discrimination-law-2018_en.pdf), fq.232.



Margjini” Shkodër. Njëkohësisht, sa më sipër, rezultoi e provuar se ankuesja dhe familja e saj janë aktivistë dhe anëtarë të Partisë Demokratike, duke provuar në këtë mënyrë bindjet e saj politike.

Ankuesja gjatë trajtimit të ankesës ka parashtruar se, *“drejtuesja e shkollës është vendosur në pozicionin që mban si militante partie”* dhe fakti që bindjet e saj politike janë të kundërta me ato të drejtores së shkollës, kanë sjellë për pasojë dhe marrjen e masës për largimin e saj nga puna. Pavarësisht këtij fakti, ankuesja nuk vuri në dispozicion të Komisionerit asnjë fakt apo argument për të vërtetuar pretendimin e saj sa i përket bindjeve politike të Drejtores së shkollës. Gjithashtu, edhe nga hulumtimet e bëra nga Komisioneri nuk u arrit të siguroheshin informacione apo prova se, Drejtorja e shkollës ka shfaqur një aktivitet të njohur politik apo bën pjesë në një prej subjekteve politike në vend.

Gjithashtu, gjatë seancës dëgjimore ankuesja ka deklaruar se me znj. A.Ll është njohur përpara se të fillonte punë në shkollë, kur punonte në Bashkinë Lezhë (2016-2021) dhe znj. A.Ll punonte në një shoqatë.

Gjithashtu, gjatë seancës dëgjimore, Drejtorja e shkollës znj. A.Ll deklaroi se: *“Ankuesen e njoh prej vitesh, përmes një projekti që kam pasur në vitet 2017-2019, në Bashkinë Lezhë. Ankueses i kam bërë thirrje që të punësohej si mësuese e lëndëve profesionale, nëpërmjet konkurrimit me dosje. Gjithashtu, njoh dhe bashkëshortin e saj dhe me kunatin e ankueses kam punuar në projekte të ndryshme dhe i di bindjet e tyre politike, por që për mua nuk ka pasur asnjë ndikim, si kur është marrë në punë e në vijim”*.

Në analizë të shkakut të pretenduar nga ankuesja, rezulton se Drejtorja e shkollës ka pasur dijeni të bindjeve politike të ankueses dhe familjarëve të saj, por pavarësisht kësaj e ka ftuar për të konkurruar dhe për të lidhur kontratën e punës me ankuesen, si mësuese në shkollë, si dhe nga ana e ankueses nuk u arrit të provohej aktiviteti politik i Drejtores së Shkollës.

Bazuar në faktet dhe provat e administruara gjatë shqyrtimit të ankesës, pavarësisht konstatimit të trajtimit të padrejtë dhe të disfavorshëm ndaj ankueses nga ana e punëdhënësit, lidhur me ndërprerjen e marrëdhënieve të punës dhe ekzistencës së shkakut të mbrojtur të diskriminimit, faktet dhe provat e administruara janë të pamjaftueshme për të krijuar prezumimin se kjo sjellje të cilës i është nënshtruar ankuesja është për shkak të bindjeve politike.

Komisioneri vlerëson se, në kushtet kur bazuar në faktet dhe provat e administruara nuk mund të prezumohet se diskriminimi ka ndodhur, Drejtorja e Shkollës së Mesme Profesionale “Kolë Margjini” Shkodër, nuk mund të ngarkohet me detyrimin për të provuar se trajtimi i padrejtë dhe më pak i favorshëm të cilit i është nënshtruar ankuesja, përbën diskriminim.

Konstatimi i trajtimit të padrejtë dhe më pak të favorshëm dhe ekzistenca e shkakut të pretenduar të diskriminimit, nuk mund të çojnë *apriori* në përfundimin se jemi përpara një sjellje diskriminuese, për sa kohë që nuk mund të prezumohet lidhja shkakësore, pra se shpjegimi i vetëm i arsyeshëm për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës të ankueses, është bindja politike.

Sjellja diskriminuese në çdo rast është një sjellje e paligjshme, por jo çdo paligjshmëri përbën diskriminim, pasi për t'u konsideruar i tillë duhet të lidhet domosdoshmërisht me një shkak të mbrojtur të LMD-së.

Sa më sipër, Komisioneri arrin në përfundimin se ankesa e paraqitur nga subjekti ankues me pretendimin për diskriminim, për shkak të *“bindjes politike”*, është e pabazuar, pasi nuk rezultoi e provuar që znj. A.LI, Drejtore e Shkollës Profesionale Pyjore “Kolë Margjini”, Shkodër të ketë shkelur dispozitat e ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### **V E N D O S I:**

1. Konstatimin e mosdiskriminimit, të subjektit ankues znj. R.Gj, në të drejtën për punësim, për shkak të bindjes politike, nga ana e znj. A.LI, Drejtore e Shkollës Profesionale Pyjore “Kolë Margjini”, Shkodër.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

**KOMISIONERI**

**Robert GAJDA**